



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA KORÇË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 13, datë 29 / 1 /2026

**“MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN NËPËRMJET  
KONKURRIMIT TË SUBJEKTIT QË DO TË PROMOVOJË KORÇËN SI  
DESTINACION TURISTIK”**

Në mbështetje të nenit 54 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar, Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, Kodi i Proçedurave Administrative, Këshilli i Bashkisë

**V E N D O S I:**

Të miratojë kriteret e nevojshme mbi bazën e të cilave do të kryhet përzgjedhja e OJF që do të promovojë korçën si destinacion turistik si më poshtë:

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË SUBJEKTIT

KRITERET LIGJORE (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të jetë person juridik ((OJF)i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi ( provuar me vendim gjykatë);
- Të ketë objekt veprimtarie të lidhur me turizmin, shërbimet informative turistike, marketingun turistik ose fusha të ngjashme;( vendim gjykatë)
- Të mos ketë detyrime tatimore, taksa, tarifa vendore dhe detyrime të prapambetura (vertetime nga andimistrata tatimore dhe bashkia);
- Të mos jetë në proces falimentimi apo likuidimi.(vertetim nga gjykata)
- Të mos jetë I denuar me vendim të formës së prerë (certifikate e gjendjes gjyqësore/ose e ngjashme)

KRITERI PROFESIONAL (10 pikë)

Subjekti duhet:

- Të provojë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve të informimit turistik ose shërbimeve të ngjashme (kontrata të mëparshme);
- Të disponojë staf të kualifikuar, me njohuri të gjuhëve të huaja dhe të trashëgimisë turistike locale (diplome, listpagesa. cv);
- Të paraqesë një plan të detajuar të organizimit dhe funksionimit të Pikës së Informimit Turistik, mënyrës si do asistojë bizneset në menaxhimin e kapaciteteve turistike, si do promovojë produktin vendas në panairë të ndryshme locale, kombetare dhe nderkombetare, dhe pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme në favor të tregut turistik;
- Të ketë minimum 10 vite eksperiencë në fushën e turizimit.

#### KAPACITETI FINANCIAR (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të demonstrojë kapacitet financiar për realizimin e shërbimit (Projekti që do të zbatohet në ofrimin e këtij shërbimi);
- Aftësi për të menaxhuar fonde dhe projekte
- Aftësi për të siguruar të ardhura shtesë (projekte donacione, partneritete) të qëndrueshme

Për kriteret e sipërcituara subjekti duhet të paraqesë dokumentacioni e kërkuar për secilin kriter në origjinal ose i njëjësuar me origjinalin.

#### PROCEDURA E KONKURIMIT

- Shpallja e thirrjes publike nga Bashkia Korçë në faqen zyrtare te ëebit të Bashkisë Korçë dhe afishim në stendën e njoftimeve;
  - Shpallja do të qëndrojë e afishuar/publikuar për një afat 2 javor nga data e afishimit;
  - Subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë aplikimet brenda afatit dy javor në zyrën e Protokoll Arkivës në Bashkinë Korçë në zarf të mbyllur;
  - Vlerësimi i aplikimeve të bëhet nga një komision i posaçëm i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë;
  - Renditja e subjekteve do të bëhet sipas pikëzimit të kriterëve;.Grupi I punes ngritur me urdher të kryetarit I paraqet raportin e vleresimit kryetarit për miratim.
  - Kryetari shpall fituesin me vendim dhe nënshkruan marrëveshjen përkatëse.
1. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë të nënshkruajë marrëveshjen me subjektin e përzgjedhur fitues për një afat 3 vjeçar nga data e nënshkrimit.
  2. Të japë me huapërdorje për subjektin fitues, objekti me sipërfaqe 16.6 m2, pjesë e pasurisë Nr. 2/492 vol 32 faqe 100, ZK 8561 për një afat 3 vjeçar, aq sa do të zgjasë dhe marrëveshja e bashkëpunimit sipas genplanit bashkangjitur.
  3. Kontrata e huapërdorjes të lidhet me një afat 3 vjeçar sa dhe marrëveshja e bashkëpunimit.
  4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, dhe Drejtoria e Turizmit dhe Projekteve të Zhvillimit në Bashkinë Korçë.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miraturar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kundër 1

Vota Abstenim 1

Zbardhur më datë 29-1-2026

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI

